

Drejtorie e Regjistrimit  
IT



ZYRA E PËRFAQËSIMIT TË  
MARPILLERO & ASSOCIATI S.R.L.  
(në likuidim)

Lënda: Ftesë për Kreditorët e Zyrës së Përfaqësimit të Marpillero & Associati S.R.L, në likuidim

Njoftimi i Dytë

Te nderuar Zotërinj,

Njoftojmë se Zyra e Përfaqësimit të Marpillero & Associati S.R.L, është shpallur me datë 03.02.2011 në proces likuidimi.

Me tej, njoftojmë se me Vendimin e datës 25.01.2011, të Marpillero & Associati S.R.L, shoqëri e krijuar sipas legjislacionit italian, e cila zotëron në Shqipëri Zyrën e Përfaqësimit, të regjistruar në Regjistrin Tregtar me NIPT K92116010V, datë 16.09.2009 dhe me seli në adresën: Rr. Mustafa Matohiti, nr. 22, Tiranë, Shqipëri (Zyra e Përfaqësimit), ka vendosur likuidimin në gjendjen e aftësisë paguese të Zyrës së Përfaqësimit. Vendimi i sipërpërmendur për kalimin në likuidim të Zyrës së Përfaqësimit është depozituar dhe regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit më datë 03.02.2011.

Unë i nënshkruari, Z. Florian Piperi, në cilësinë e likuiduesit të Zyrës së Përfaqësimit të Marpillero & Associati S.R.L, bazuar në ligjin "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", nëpërmjet kësaj shkrese

ftoj për herë të dytë dhe përfundimtare, në vijim të ftesës së parë të publikuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit më datë 8 mars 2011, të gjithë kreditorët e Zyrës së Përfaqësimit si dhe çdo person tjetër që pretendon detyrime të pashlyera nga Zyra e Përfaqësimit, të depozitojë pranë Optima Legal & Financial, në adresën: Rr. Dëshmorët e 4 Shkurtit, Sky Tower, kati 8/3, Tiranë, çdo kërkesë apo pretendim ndaj Zyrës së Përfaqësimit brenda 30 ditëve nga data e publikimit të këtij njoftimi në faqen zyrtare të internetit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Për çdo informacion të nevojshëm lidhur me likuidimin e Zyrës së Përfaqësimit, lutem më kontaktoni nga ora 09.00 deri në ora 18.00 në adresën Rr. Dëshmorët e 4 Shkurtit, Sky Tower, kati 8/3, Tiranë.

Me nderime,  
Likuidues  
Florian Piperi